



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1596, datë 04.05.2011

Për

“Fillimin e procedimit administrative për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Vodafone Albania sh.a dhe Plus Communication sh.a”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 04.05.2011, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brëndshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Vodafone Albania sh.a dhe Plus Communication sh.a.

BAZA LIGJORE:

1. Neni 49, neni 50 pika 1 dhe neni 60 e vijues, pika te ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 9918*);
2. Neni 46 e vijues të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
3. Rregullore nr. 18 “Për procedurat e zgjidhjes se mosmarrëveshjeve”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1296, datë 11.06.2010;
4. Rregullore nr. 19 “Për Aksesin dhe Interkoneksionin”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar;

5. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (*Rregullorja e Brendshme*), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918,

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Shkresa nr. CEO/033/E.Xh ref, datë 06.04.2011 1 e Vodafone Albania sh.a “Kërkesë për fillimin e procedimit administrativ dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjes mes Vodafone dhe Plus për lidhjen e marrëveshjes së re të interkoneksionit dhe zbatimit të çmimeve të rekomanduara të Plus në bazë të VKD nr. 1505 datë 10.02.2011”;
- Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (*Relacioni*);
- Korrespondenca me e-mail midis palëve,
si dhe
duke i’u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

- I. Vodafone AL, me shkresën nr. CEO/033/E.Xh, datë 06.04.2011 “Kërkesë për fillimin e procedimit administrativ dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjes mes Vodafone dhe Plus për lidhjen e marrëveshjes së re të interkoneksionit dhe zbatimit të çmimeve të rekomanduara të Plus në bazë të VKD nr. 1505 datë 10.02.2011”, (AKEP: nr. 293/25 prot, datë 07.04.2011), bashkëlidhur dhe korrespondenca me e-mail midis palëve, sqaron se:
1. Plus ka dështuar të kryejë negociata dhe për rrjedhojë të firmosë MI brënda afateve të përcaktuara në nenin 50 të Ligj nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, për shkak të refuzimit të këtij operatori për të zbatuar kuadrin rregullator dhe vonesave të pajustificuara në kohë për kthim përgjigje;
 2. Vodafone AL konsideron se, Plus ka kundërshtuar haptazi zbatimin VKD nr. 1468, datë 23.12.2010 “Për Miratimi i Ofertës Referencë të Interkoneksionit të Vodafone Albania sh.a”, duke vlerësuar se VKD nr. 1468 për fuqinë ligjore që disponon nuk është objekt negociatash mes palëve, por implementohet i pandryshueshëm;
 3. Vodafone AL vlerëson se, Plus ka kundërshtuar haptazi zbatimin e VKD nr. 1505 duke mos e njohur si të ligjshme tarifat që AKEP ka miratuar, dhe se Plus këmbëngul që në Marrëveshjen e re tarifa e terminimit në rrjetin e tij të jetë prej 18.9 lek/min dhe 0.57 lek/thirrje, ndërkoh që Vodafone ka insistuar që për aplikimin e tarifës 15.93 lek/min pa aplikuar tarifë për thirrje si rezulton edhe në VKD nr. 1505, datë 10.02.2011 të AKEP;
 4. Vodafone thekson se kjo situat krijon konflikt në lidhje me faturimin midis palëve dhe njohjen e faturave, pasi brënda datës 5 të muajit pasardhës palët në përputhje me Ligjin për TVSH dhe dispozitave ne ORI duhet të shkëmbejnë faturat e shërbimeve të interkoneksionit;
 5. Vodafone argumenton se, deri më 1.03.2011, raporti i asimetrisë së tarifave të terminimit midis Vodafone dhe Plus ka qënë në masën 80%, ndërkoh që me anë të VKD nr. 1505, tarifa e terminimit të Vodafone është ulur në 8.85 lek/min. Plus pretendon të mbajë të

njëjtën tarifë prej 18.9 lek/min dhe 0.57 lek/thirrje, kjo do të thote se duke filluar nga data 1.03.2011 nese do të ndiqet pretendimi i Plus, asimetria midis dy operatorëve të shkojë në 115%, pa llogaritur këtu dhe aplikimin e tarifës për thirrje që ndikon edhe më tepër në nivelin e asimetrisë;

6. Vodafone AL thekson se, pavarësisht ankimit administrativ të saj ndaj VKD-ve nr. 1507, nr. 1508, nr. 1505 datë 10.02.2011, Vodafone AL ka lidhur MI në zbatim të tarifave të përcaktuara nga AKEP sipas VKD nr. 1505;
7. Vodafone konsideron se, Plus me anë të kthimit të përgjigjeve me email të datës 07.03.2011 dhe 17.03.2011 (bashkelidhur) ka refuzuar të njohë dhe të pranojë tarifën prej 15.93 lek/min duke filluar nga data 01.03.2011 deri në 31.08.2011 sipas përcaktimeve të AKEP, njëkohësisht Plus ka refuzuar të njohë përcaktimin e AKEP për mos aplimin e tarifës për thirrje;
8. Vodafone, sjell në vëmendje të AKEP, VKD nr. 1351, datë 4.08.2010 dhe VKD nr. 1211 datë 31.03.2010, duke kërkuar ndërhyrjen e menjëhershme të AKEP pasi mungesa e rregullimit po rezulton në konflikt të vazhdueshëm për lidhjen e marrëveshjes së interkoneksionit me Plus, si dhe mos shpallja e këtij të fundi Operator me Fuqi të Ndjeshme në Tregun e terminimit në rrjetin përkatës ka legjitimur indiferencën e Plus për të mos zbatuar vendimet rregullatore të AKEP;
9. *Për sa më sipër Vodafone Albania në përputhje me përcaktimet në nenin 50, 60 dhe 120 të Ligj nr. 9918, dt. 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, nenet 46, 66, 99, 100 dhe 112 të Ligj nr. 8485 dt. 12.05.1999 K.Pr.A, nenet 5, 6 dhe 7 të Rregullores nr. 18 “Për Procedurat e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve”, neni 15 i Rregullore nr. 19 “Për Aksesin dhe interkoneksionin” , si dhe VKD nr. 1351 dt. 04.08.2010, kërkon që AKEP:*
 - Të nxjerrë sa më shpejtë një Vendim që detyron operatorin Plus Communication të zbatojë tarifën e rekomanduara në bazë të VKD nr. 1505 datë 10.02.2011;
 - Të lëshojë një Urdhër në zbatim të nenit 60 të Ligj nr. 9918 datë 19.05.2008 për lidhjen e Marrëveshjes së re të Interkoneksionit midis Vodafone Albania dhe Plus Communication ku të pasqyrohen tarifën sipas vlerave dhe afateve të lartpërmendura dhe të zbatohen dispozitat e Ofertës Reference të Interkoneksionit të Vodafone Albania sh.a;
10. AKEP për sa më sipër në zbatim edhe të nenit 50 të ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” zgjidhja e mosmarrëveshjes midis sipërmarrësve mund të kryhet në bazë të kërkesës së një sipërmarrësi apo me inisiativën e AKEP,

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të Ligjit nr. 9918, nenin 46 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brëndshme,

V E N D O S:

1. Të fillojë procedimim administrativ, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis Vodafone Albania sh.a dhe Plus Communication sh.a.;
 2. Të ngrihet komisioni për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me përbërje si:
 - Altin Rrapaj Kryetar
 - Jonida Gjika Anëtar
 - Përparim Buçaj Anëtar
 - Florida Çela Anëtar
 - Xhenisa Nela Anëtar
 3. Të njoftohen palët e interesuara Vodafone Albania sh.a dhe Plus Communication për fillimin e procedimit administrativ;
 4. Palët të depozitojnë pretendimet e tyre me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja e Vendimit;
 5. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al
- Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I
Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURCE**